

**AKT THEMELIMI I
SHOQËRISË TREGTARE
“M&M 21” SH.P.K
ME SELI NË TIRANË**

Sot, më datë 23 Korrik 2021 (dymijënjëzetënjë):

- **Znj. Manjola SEFERI**, shtetase shqiptare, e datëlindjes 18.04.1967, lindur në Tiranë dhe bauese në Tiranë, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e kartës së identitetit me numër peronal G75418060G
- **Znj. Miranda LAKO**, shtetase shqiptare, e datëlindjes 21.03.1966, lindur në Tiranë dhe bauese në Tiranë, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar mbajtëse e kartës së identitetit me numër peronal G65321141R.
- **Z. Andri DERVISHI**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 12.01.1987, lindur në Librazhd dhe baues në Tiranë, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me numër peronal I70112048J .

Vendosi:

Themelimin e shoqërisë tregtare “M&M 21” SH.P.K, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqërinë Tregtare “M&M 21” SH.P.K, është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (në vazhdim Shoqëria). Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

NENI 2

Emri i shoqërisë


Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “M&M 21” SH.P.K

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Objekt i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë kryerja e çdo aktiviteti tregtar të lejuar nga ligji dhe/ose pjesëmarrja në çdo veprimtari apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e krijuar në bazë të legjislativës shqiptare, siç mund të ndryshohet here pas here dhe në veçanti, por pa u kufizuar në;

- **Import-eksport, import dhe tregtimi me shumicë dhe me pakicë i veshjeve, për gra, burra dhe fëmijë. Import-eksport, import dhe tregtimi me**



shumicë dhe me pakicë, aksesorëve si këpucë, sandale, çanta, rripa, bizhuteri etj..për gra, burra dhe fëmijë.

Gjithashtu, shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër që lidhet direkt ose indirekt, që është rezultat ose lidhet me objektivin e mësipërm, çdo aktivitet tjetër tregtar, financiar, qiraje ose hipoteke, si dhe çdo veprimtari me pasuri të luajshme ose të paluajshme që mund të konsiderohet i nevojshëm për ushtrimin e veprimtarisë sipas objektit të shoqërisë.

Për ushtrim të aktivitetit të shoqërisë me gjithë ndryshimet që mund të ketë shoqëria mund të hyjë më marrëveshje partneriteti dhe bashkëpunimi me palë të tretë qofshin ente publike apo private, të marrë pjesë në procedura të ndryshme konkurrimi në përputhje me legjislacionin në fuqi. Të gjitha veprimtaritë do të zhvillohen në përputhje me ligjin që rregullon ushtrimin e asaj veprimtarie. Shoqëria do të marrë të gjitha licencat dhe miratimet që mund të jenë të nevojshme për zhvillimin e veprimtarive të sipërpërmendura sipas kërkesave të ligjit të fushës.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, “Long Hill Residence”, ZK.2735, Psuria Nr. 53/83, Petrelë, Tiranë.

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në vlerën prej 300,000 (treqindmijë) lek.

Ortakët themelues të Shoqërisë zotërojnë kuotat si më poshtë:

- **Manjola SEFERI** në cilësinë e ortakut themelues zotëron 33% të vlerës së kapitalit themeltar të Shoqërisë të barabartë me 1 kuotë me vlerë nominale 99,000 (nëntëdhjetënjëntëmijë) lek.
- **Miranda LAKO** në cilësinë e ortakut themelues zotëron 34% të vlerës së kapitalit themeltar të Shoqërisë të barabartë me 1 kuotë me vlerë nominale nominale 102,000 (njëqindedy mijë) lek.
- **Andri DERVISHI** në cilësinë e ortakut themelues zotëron 33% të vlerës së kapitalit themeltar të Shoqërisë të barabartë me 1 kuotë me vlerë nominale 99,000 (nëntëdhjetënjëntëmijë) lek.

Kapitali themeltar është investuar nga ortakët themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga Ortakët themelues në rast të miratimit të kësaj kontrate themelimi dhe të firmosur nga ta.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktiviteti fillon pas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurtohet, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

- Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve– organi më i lartë vendimmarrës;
- Administratori/ët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet nga Administratorët të cilët zgjidhen për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

- **Administratori i Shoqërisë do të jetë Zj. Miranda LAKO, shtetase shqiptare, e datëlindjes 21.03.1966, lindur në Tiranë dhe bauese në Tiranë, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar mbajtëse e kartës së identitetit me numër peronal G65321141R.**

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi

NENI 8

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 9

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 10

Ligji i aplikueshëm

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga ortakët/u themelues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

NENI 12

Dispozitat përfundimtare


Akti i Themelimi hartohet në katër kopje në gjuhën shqipe dhe është në përputhje me vullnetin e lirë të themeluesit, i cili, nëpërmjet përfaqësuesve të tij e nënshkruan pa vërejtje.

ORTAKËT THEMELUES

Manjola SEFERI



Miranda LAKO

Miranda Lako


Andri DERVISHI

